



- [Home](#)
- [Lajme »](#)
- [Intervista](#)
- [Opinione](#)
- [Sport](#)
- [Ekonomi](#)
- [Kultura](#)
- [Fotogaleri](#)
- [Multimedia »](#)

Projekt për financimin e universiteteve publike



11.11.2014 - 11:30

[Tweet](#) 0 [Like](#) 0 [g+1](#) 0

[Home](#) » [Kosova](#), [Lajme](#) » Projekt për financimin e universiteteve publike

Prishtinë, 11 nëntor 2014 – Ka filluar tryesa e rrumbullakët “Autonomia dhe llogaridhënia financiare e institucioneve publike të arsimit të lartë në Kosovë”, në

- [Latest](#)
- [Popular](#)
- [Random](#)
- [Tags](#)



RTS: Rama në Kosovë pritet me hartën e Shqipërisë...

- 20:38



Pyjet e vendit po shkatërrohen

- 20:34

ndërtesën e Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, ku u diskutua për sfidat dhe perspektivat e financimit të arsimit të lartë publik në Kosovë.



Në ditën e parë, u prezantuan mënyrat e financimit të arsimit të lartë (AL) në Kosovë, menaxhimi financier i institucioneve publike të arsimit të lartë, eksperiencat e partnerëve nga Evropa në lidhje me: autonominë dhe llogaridhëni financiare e institucioneve publike të AL, si dhe modelet e shpërndarjes së buxheteve.

Dita e parë u përballet me diskutimin në lidhje me sfidat dhe perspektivat e financimit të arsimit të lartë në Kosovë.

Drejtoresha e Departamentit të Arsimit të Lartë në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), Drita Kadriu, ka thënë se kjo tryezë ka për qëllim shkëmbimin e përvojave nga universitete të ndryshme të botës.

Kurse, përfaqësuesja e Bashkimit Evropian në Kosovë, Sophie Beaumont, ka thënë se ky projekt është i rëndësishëm për arsimin e lartë, pasi një gjë e tillë, sipas saj, do të sjellë dobi për gjenerimin e të ardhurave në këto institucione arsimore.

Kurse në ditën e dytë, dhe të retë do të punohet në një dokument strategjik që do të përmbarë parimet, objektivat dhe indikatorët për krijimin e një sistemi më të avancuar të financimit të arsimit të lartë publik në Kosovë. Në këtë tryezë të ftuar janë edhe përfaqësues nga: Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë e Republikës së Kosovës, Agjencia e Akreditimit të Kosovës, Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", Universiteti i Prizrenit "Ukshin Hoti", Universiteti "Haxhi Zeka" Pejë, Universiteti i Gjilanit "Kadri Zeka", Universiteti i Mitrovicës "Isa Boletini", Universiteti i Gjakovës "Fehmi Agani", Universiteti FH CAMPUS ËIEN (Austri), Universiteti Alikante (Spanjë), Universiteti Sarland (Gjermani), Zyra ERASMUS+ ne Kosovë, ËUS Kosova dhe institucionet ndërkombëtare që e mbështesin zhvillimin e arsimit të lartë në Kosovë.

Tryeza është organizuar në kuadër të projekteve "Ngritura e autonomisë dhe llogaridhënieve financiare në institucionet publike të arsimit të lartë në Kosovë", financuar nga Komisioni Evropian, përmes programit TEMPUS. /KI/

[Tweet 0](#)

[Like 0](#)

[8 +1 0](#)

Ritmet përsiatëse të një Universi poetik

- 20:30



Cliff: E ardhmja e Kosovës përfundimisht është në BE

- 20:11



Peja mposhtet në Ligën Ballkanike

- 19:52

Komentet e Fundit

- Andi Ballshi on [Saltomortalët e neokomunistit Shpend Ahmeti](#)
- Enis on [Plagosje në Podujevë, arrestohet i dyshuar](#)
- Edon Rama on [Plagosje në Podujevë, arrestohet i dyshuar](#)
- Iloka on [Plagosje në Podujevë, arrestohet i dyshuar](#)
- Adrian Kodra on [Zemra në lak, fituese e Zambakut të Prizrenit](#)

Na gjeni në Facebook